



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/47;
Datë: 29.04.2015 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-004-3579	2	07.05.2015

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22.1 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.04.2015, nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të

(projekt) Rregullores për punën e Komitetit për Shërbime Publike

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) Rregullores për punën e Komitetit për Shërbime Publike/në tekstin e mëtejme (projekt) Rregullorja/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është rregullimi i punës së Komitetit për Shërbime Publike, detyrat dhe përgjegjësitë si dhe obligimet e këtij komiteti që nuk janë të përcaktuara me ndonjë dispozitë ligjore.
- III. Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Shërbime Publike, Inspekcion, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që rregulloren ta hartojë në afat prej 4 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. Projekt Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e projekt Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim.

XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>